



GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbartimore të kreditorit P...F... Sh.P.K., me numër unik identifikues ... dhe seli në Prishtinë, Sheshi “...”, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson M.D., avokat nga Mitrovica, kundër debitorit “A...K...” Sh.P.K., me numër unik identifikues dhe seli në, p.nr.,, Komuna e Obiliqit, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 262/21, i lejuar më datë 19.10.2021, nga Përmbartuesi Privat Ilir Miftaraj, me seli në Mitrovicë, jashtë seancës, me datë 28.04.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “A...K...” Sh.P.K., me numër unik identifikues, ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr. 262/21, i lejuar më datë 19.10.2021, nga Përmbartuesi Privat Ilir Miftaraj, ANULOHET

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit P...F... Sh.P.K., mbi bazën e dokumentit të besueshëm - Faturës nr. F08/21, e datës 31.08.2021, ka lejuar urdhrin për përmbartim P.nr.262/21, të datës 19.10.2021, me të cilin është urdhëruar debitori A...K... Sh.P.K., që në afat prej 7 ditësh nda dita e dorëzimit të urdhrin, t’ia paguaj kreditorit shumë prej EUR 11,000.00, së bashku me shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori, në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor me arsyetim se fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri nuk është e nënshkruar apo vulosur nga debitori, dhe se të njëjtën faturë nuk e ka pranuar si detyrim pasi që nuk ka pranuar asnjë shërbim nga kreditori. Tutje, ka kontestuar dorëzimin e faturës përmes postës me arsyetim se në dëftesën e pranimit të dërgesës nuk është specifikuar lloji dhe përmbajtja e dërgesës. Ndërsa, gjykatës i ka propozuar që urdhrin përmbartimor ta anuloj.

Kreditori, në përgjigje në prapësim të ushtruar përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka theksuar se procedura përbarimore është iniciuar mbi bazën e faturës e cila i përmban të gjitha elementet e nevojshme për tu konsideruar si dokument i besueshëm. Tutje, ka shtuar se kreditori ka pasur marrëveshje me debitorin për furnizim të caktuar dhe se kreditori ka furnizuar debitorin me kohë dhe në përpikëri duke i ofruar produktet e veta sipas kërkesës së debitorit. Gjykatës i ka propozuar që prapësimi i debitorit të refuzohet në tërësi i pabazuar, ndërsa urdhri përbarimor të mbetet në fuqi. Poashtu, i ka kërkuar shpenzimet në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësim, në lartësi prej EUR 208.00, konform rregullores mbi tarifën e avokatëve.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe përgjigje në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (në tekstin e mëtejshëm: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përbarimor duhet të anulohet, për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së, *“Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa, pika 1.3 e njejtit nen ka përcaktuar faturën si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, në paragrafin 3 të këtij neni është përcaktuar se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Në anën tjetër, me nenin 37 të LPP-së parashihet se: *“Kur propozimi për përbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit*.

Gjykata, duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se faturës mbi bazën e të cilave është lejuar urdhri përbarimor, i mungon objekti, përkatësisht në faturë nuk janë emërtuar mallrat apo shërbimet me të cilat kreditori është shërbyer nga debitori, element ky i domosdoshëm i përcaktuar në dispozitën nga neni 29, paragrafi 3 të LPP-së, mungesa e së cilit e bënë dokumentin të papërshtatshëm për përbarim.

Gjithashtu, gjykata gjen se fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri nuk i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm në kuptim të nenit 29, paragraf 3 të LPP-

së, ngase nuk mund të vërtetohet që e njëjta është dorëzuar në mënyrë të rregullt nga ana e kreditorit dhe se është pranuar nga debitori, për arsye se të njëjës i mungon nënshkrimi apo vula e debitorit. Në anën tjetër, kreditori nuk ka arritur të dëshmojë se në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme ia ka dorëzuar debitorit, ndërsa ky i fundit i ka pranuar faturat në fjalë dhe është njoftuar me detyrimin që rrjedhë nga e njëjta. Andaj, fatura lëshuar nga kreditori, mirëpo e papranuar nga ana e debitorit, si e tillë, përbën dokument të njëanshëm dhe jo të përshtatshëm për përmbarrim.

Gjykata, ka vlerësuar dëftesën për pranimin e dërgesës me numër serik 2010202164976, e datës 13.09.2021, e cila gjendet në shkresa të lëndës dhe e cila është adresuar për debitorin, por që gjeti se e njëjta paraqet dëshmi vetëm në raport me dërgimin e shkresave, mirëpo jo edhe dëshmi mbi pranimin e tyre nga ana e debitorit. Për më tepër, në dëftesën në fjalë nuk është specifikuar lloji dhe përmbajtja e dërgesës, rrjedhimisht nuk dihet nëse dërgesa ka qenë me përmbajtje të faturën mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri, andaj gjykata një dorëzim të tillë nuk mund ta konsideroj si të rregull.

Bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm, mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbarrim, e mbi bazën e të cilit Përmbarruesi privat ka lejuar përmbarrimin, nuk ka tipare të përmbarrueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbarruesit duhet të anulohet.

Nga sa më sipër, në kuptim të nenit 71, paragrafi 1.1 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1002/22, datë 28.04.2023

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.